



Pranuar / Dorezuar Priljepljen / Prodato Received / Delivered	05.12.2022	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMBASHI	7684/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.862/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.862/2022 të datës 05.10.2022 të parashtruar nga ankuesi me adrese banimi rruga

kundër Vendimit me numër të protokollit 995 të datës 30.09.2022 të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike 'Kërkese nga marrëdhënia e punës', duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 05.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI ADMINISTRATIV i iniciuar me ankesën A.nr.862/2022 të datës 05.10.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 05.10.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër vendimit me numër të protokollit 995 të datës 30.09.2022 të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me pretendimet ankimore moszbatim i vendimit me numër A.nr.675/2022 të datës 09.09.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, si dhe moszbatimin e dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueset në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli, më datë 13.10.2022 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen ankimore në vendosje.

Me datën 17.11.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr.155/2022 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vendosjes meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 05.10.2022 me numër protokolli 5890/2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 995 të datës 30.09.2022 të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Vendimin A.nr, 675/2022 të datës 09.09.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 6062/2022 te datës 11.01.02022 Përgjigjen ne ankesë me numër të protokollit 6138/2022 të datës 13.10.2022; Akt emërimin me numër AE.Nr.072/2022 të datës 30.09.2022; Kontratën e punës te datës 07.02.2018 të ankuesit; Emalin e datës 11.1.02022 të drejtuar Emalin e datës 11.10.20252 të drejtuar Vendimin me numër VK.nr.155/2022 të datës 17.11.2022; Provat shtesë me numër te protokollit 7176/2022 të datës 17.11.2022; Përshkrimin e detyra te punës të datës 16.11.2022; Akt emërimin me NR.072/2022 të datës 30.09.2022; Kontratën e punës me numër 1002258346 të datës 09.03.2012 Kontratën e punës të datës 30/03/2016; Kontratën e punës të datës 07.02.2018; Akt emërimin e datës 26.02.2013; Kontratën e punës të datës 01.07.2007; Kontratën e punës me numër 336/BD të datës 01.07.2010; Diplomën universitare me NR.268 të datës 08.05.2018; Certifikatën me NR.6582/361 të datës 11.05.2005; Vërtetimin nen shenjen LRP.nr.4045/2017; Vendimin me numër të protokollit 995 te datës 30.09.2022

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha rrethanat ligjore për të *përfunduar procedimin administrativ* i filluar me ankesën e ankuesit *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi në bazë të Ligjit Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, ankuesi mbanë pozitën e *Zëvendës drejtor i Qendrës së Paraburgimit* në Pejë, për periudhën kohore 30.03.2018 deri më datë 29.03.2023. I njëjti me datën 29.07.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendim që me rastin e përfundimit të mandatit si Zëvendës Drejtor i Qendrës se Paraburgimit në Pejë ti rregullohet marrëdhënia e punës me akt emërimin me afat të pacaktuar.

Këshillin i Pavarur Mbikëqyrë për Shërbim Civil të Kosovës me datën 09.09.2022 përmes Vendimit A.nr.675/2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar duke e obliguar Menaxherin e Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës që brenda pesëmbëdhjetë ditës (15) nga dita e pranimit te vendimit, ti ndër marr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për rregullimin e statusit te ankuesit në pajtim me dispozitat e Ligjit për Zyrtar Publikë. Ndërsa me qëllim të zbatimit të Këshillit A.nr.675/2022 të datës 09.09.2022, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës përmes vendimit me numër protokolli 995 të datës 30.09.2022, ka zbatuar vendimin e Këshillit te Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil te Kosovës, duke ia rregulluar ankuesit statusin e nëpunësit civil, gjegjësisht përmes vendimit të goditur me këtë ankesë është përcaktuar se

ankuesi pas përfundimit të kontratës së punës me datë 29.03.2023 do të sistemohet në mënyrë të përhershme pozitën "Udhëheqës i Njësisë për Transportin e të Burgosurve në Qendron Korrektuese në Dubravë" me akt emërim të përhershëm.

Kolegji i Këshillit përpara se të lëshohet në shqyrtim të pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e nenit 101 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike," dhe mbi këtë bazë ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore që të përfundohet procedimi administrativ i filluar me ankesën e ankuesit të datës 05.10.2022, pasi që ankesa e palës është bazuar mbi të njëjtën situatë faktike dhe ka të njëjtin qëllim sikurse në ankesën e datës 29.07.2022 ku i njëjti kishte kërkuar që marrëdhënia e tij e punës t'i rregullohet në mënyrë të përhershme me akt emërim siç përcaktohet me nenin 32 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat e Publik dhe të njëjtën ankesë Këshilli e ka shqyrtuar dhe ka vendosur përmes Vendimit A.nr.675/2022 të datës 09.09.2022, rrjedhimisht ankuesi brenda periudhës kohore prej pesë (5) muajsh ka parashtruar dy ankesa për njëjtin qëllim duke u bazuar mbi të njëjtën situatë faktike andaj mbi këtë Kolegji i Këshillit ka përfunduar procedimin administrativ të kësaj lënde.

Andaj theksuar si me sipër, u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.862/2022

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.